



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 07.08.2018,
e cila filloi në orën 14:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Visare Gashi (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Milazim Vitija (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Sokol Berisha (AAK), Yll Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), Bukurie Canolli (LB) dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Uran Ismaili (PDK), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV) dhe Florida Canolli (PDK).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Eman Rrahmani propozoi që të hiqen nga rendi i ditës pikat të cilat kanë të bëjnë me këmbimin e pronave, përveç aty ku ka të bëjë me ndërtimin e shkollës. Do të duhej që drejtoria përkatëse të bëjë një data-bazë publike, e cila në bazë të kërkesave dhe datës së kërkesës të merren me prioritet, pra të krijohet një standard, ku do të bëhet publike lista e pronarëve që janë në pritje për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, tha se deri në vitin 2014, pronat komunale që kanë qenë brenda blloqeve, nuk janë trajtuar fare dhe kanë mbetur të pashfrytëzuara, apo më mirë me thanë të shfrytëzuara nga privatët, por pa u shfrytëzuar nga Komuna, pra kanë mbetur toka të cilat u kanë shërbyer atyre komplekseve për parking për interes privat.

Nga viti 2014, Komuna e Prishtinës e ka filluar një proces shumë të mirë, ku pronat që janë në pronësi të Komunës së Prishtinës, këmbehen me pronat private që janë te planifikuara për interes publik.

Agim Gashi kërkoi që materialet të jenë të kompletuara për mbledhjet e radhës, pra të jetë materiali komplet, në mënyrë që të dimë për çka po votojmë, të jenë me adresë të saktë dhe sipërfaqe të saktë.

Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, tha se edhe më parë shumë herë janë votuar pikat që nuk kanë qenë të kompletuara me materiale të tjera shtesë, andaj do të kujdesem që në të ardhmen të sillen materialet komplet me dokumentacion tjetër shtesë.

Shefki Gashi u shpreh që të mos ndahet asnjëra nga këto pika që kanë të bëjnë me këmbimin e pronave, pra të kalojnë këto pika që kanë të bëjnë me këmbimin e pronës, që të mos ndërpriten punimet, çoftë ato private apo publike. Si Kuvend i Komunës, nuk guxojmë të lejojmë që si pasojë e inateve apo ndarjeve politike, të pësojë qytetari ose institucioni.

Leutrim Retkoceri, lidhur me pikën "Propozimvendimi për ndërrimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat te Herticët", pyeti se emri i dëshmorit Hasan Ramadani a është vendosur në ndonjë rrugë tjetër dhe nëse jo, atëherë ne nuk do ta përkrahim këtë ndërrim, sepse nuk jemi për heqjen e emrit të një dëshmori dhe vendosjen e një emri tjetër.

Jeta Rafuna propozoi që pika "Propozimvendimi për ndërrimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat te Herticët", të shtyhet për diskutim për një mbledhje tjetër, sepse emërtimi i rrugës në vendim është ndryshe dhe në memorandum është ndryshe. Ajo kërkoi që kjo të sqarohet më mirë nga drejtori i drejtorisë përkatëse.

Rifat Deri u shpreh se, duke pasur parasysh ndërrimet e emrave të disa rrugëve, propozoj që, për mbledhjen e radhës, në rend dite të parashihet edhe formimi i një komisioni për riemërimin e rrugëve dhe institucioneve në komunën e Prishtinës.

Nol Nushi, lidhur me këmbimin e pronave, parashtroi një problem që e kanë banoret në lagjen "Banesat e Bardha", përballë marketit "Emona". Aty një kompleks i tërë banesor, qasje në rrugën kryesore kanë vetëm përmes një rripi të tokës private, i cili është i pamundur me u shpronësuar. Ai kërkoi të dijë se a është në prioritet, apo ka ndonjë plan Komuna për zgjidhjen e këtij problemi.

Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, theksoi se për këmbimin e një prone private me pronën komunale, duhet me qenë e planifikuar, por këmbimi iniciohet kur prona që është në pronësi të Komunës ndodhet brenda bllokut ndërtimor, i cili është në zhvillim e sipër, pra ka kërkesë për leje ndërtimore në atë bllok.

Visare Gorani - Gashi tha se sa i përket Propozimvendimit për ndërrimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat te Herticët", mendoj se këto vendime po merren shumë "ad hoc" dhe ato po ndërrohen varësisht nga situata, andaj kërkoi që për propozime të tilla të jemi më sistematik në emërtimin e rrugëve.

Vala Peshku propozoi që në rend dite të futet pika "Diskutim për Ndërmarrjen Publike Banesore, pasi që kjo ndërmarrje nuk ka Bord të aksionarëve dhe është jashtë funksionit. Kjo është e vetmja ndërmarrje nga e cila nuk do të mund të kërkojmë raport.

Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, tha se ky propozim për diskutim për Ndërmarrjen Publike Banesore, nuk ka pengesë ligjore që të votohet për të hyrë si pikë e rendit të ditës.

Leonora Shabani - Bajraktari theksoi se dje është marrë vendimi që për ndërmarrjet publike të raportohet në shtator, në mbledhjen e shtatorit, andaj mos të humbim kohë duke diskutuar sot për këtë çështje.

Kryesuesi propozoi që kjo çështje të mbetet në kompetencë të ekzekutivit, të tërhiqen apo të mos tërhiqen këto pika të propozuara. Ai tha se kjo ndërmarrje është në situatë jo të mirë, pra dje ka qenë kërkesa që të diskutohet për ndërmarrjet publike, që ne nuk kishim as informacion, as nuk kish situatë urgjente për me u diskutuar për të gjitha ndërmarrjet.

Sami Boroci u shpreh se ne si GP e votojmë që të futet si pikë e rendit të ditës, mirëpo ndoshta është zgjidhje e mirë që në shtator të trajtohen edhe ndërmarrjet tjera.

Muhedin Nushi, drejtor i Drejtorisë së Administratës, tha se duke u bazuar në diskutimet e parafolësve lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, propozoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës dhe të jetë për diskutim në mbledhjen e shtatorit.

Fiknete Bejta theksoi se kam shumë respekt për familjen Hertica, por për të mos keqkuptuar, kisha kërkuar të respektohen shkollat te Herticët, sepse ka shumë familje që kanë kontribuar në këtë drejtim. Unë jam pjesë e një familje të tillë, ku baba im ka dhënë ambulancën për shtetin, Qeverinë e Kosovës, në vitin 1999.

Kryesuesi hodhi në votim, që pika e parë e rendit të ditës "Propozimvendimi për ndërrimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat te Herticët", të hiqet nga rendi i ditës, dhe si pikë shtesë për rend dite të jetë "Diskutim për Ndërmarrjen Publike Banesore".

Kryesuesi konstatoi se më 26 votë për, hiqet nga rendi i ditës "Propozimvendimi për ndërrimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat te Herticët" dhe si pikë shtesë në rend dite futet pika "Diskutim për Ndërmarrjen Publike Banesore".

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua ky

REND I DITËS:

1. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Trio Konstruktion";
2. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Al Trade";
3. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për "Motrat e Shën Kryqit";
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Feti Selmani";
5. Propozimvendimi për miratimin e Planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Prishtinës 2018- 2021;
6. Diskutim për gjendjen në Ndërmarrjen Publike Banesore;
7. Pyetje dhe përgjigje;
8. Të ndryshme.

Pika e parë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Trio Konstruktion".

Kryesuesi hapi diskutimin.

Lidhur me Propozimvendimin për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Trio Konstruktion", të pranishmit i informoi Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës.

Naime Osmani kërkoi të dijë se sa është vlera monetare e një ari tokë në Zllatar.

Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, tha se vlera monetare e një ari përcaktohet me ligj, por në mungesë të mjeteve financiare, jemi të detyruar të bëjmë këmbimin e pronave.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Trio Konstruktion".

Pika e dytë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Al Trade".

Kryesuesi hapi diskutimin.

Leutrim Retkoceri tha se duhet të ketë transparencë më të madhe në këmbimin e pronave, që këto këmbime të na sqarohen më në detale.

Dren Kukaj, drejtori Drejtorisë së Pronës,, tha se ky këmbim ka të bëjë me nevojat e shkollës në lagjen "Veterniku".

Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, tha se prona private e cila është në pronësi të "AL Trade" SHPK, është e planifikuar për shkollë. Në vitin 2017, Kuvendi veç e ka miratuar një këmbim me këtë pronë me një pronë në pronësi të Komunës, mirëpo gjatë fazës së hartimit të kontratës së këmbimit është shfaqur pala private, e cila ka pretendime në pronën komunale, e cila ka paraqitur padi për vërtetim pronësie për atë pronë dhe është pamundësuar këmbimi.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Al Trade".

Pika e tretë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për "Motrat e Shën Kryqit".

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, 1 kundër, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për "Motrat e Shën Kryqit"

Pika e katërt

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Feti Selmani".

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, 1 kundër, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Feti Selmani".

Pika e pestë

Propozimvendimi për miratimin e Planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Prishtinës 2018- 2021.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 1 kundër, u miratua Planit lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Prishtinës 2018- 2021.

Pika e gjashtë

Gjendja në Ndërmarrjen Publike Banesore.

Kryesuesi e hapi diskutimin.

Nol Nushi tha se Ndërmarrja Publike Banesore është e vetmja ndërmarrje publike që tash për tash nuk e ka Komisionin e plotë të aksionarëve, pasi që njëri prej aksionarëve që ka qenë është shkarkuar me votë të këtij kuvendi.

Mendoj se kjo është urgjencë për trajtim, për shkak se kjo ndërmarrje është ndërmarrje me potencial milionësh dhe nuk mundemi të lejojmë që gjithë menaxhimi i kësaj ndërmarrje të lihet në duar të një menaxhmenti, të cilit tash më i ka kaluar mandati.

Sami Boroci tha se Ndërmarrja Publike Banesore në pjesën e parë të këtij viti, ka pasur probleme të veta për shkak të zhvillimeve të reja të krijuara në politikën lokale të Prishtinës, ose në koalicionin që është bërë, dhe është koha për të reaguar në këtë rast me e funksionalizuar Komisionin e aksionarëve.

Leutrim Retkoceri theksoi se ne si grup i këshilltarëve komunalë të PDK-së në Komunën e Prishtinës, qysh para një muaji kemi dalë me një konferencë, ku i kemi shprehur shqetësimet në lidhje me Ndërmarrjen Publike Banesore. Po ashtu, para dy muajve kemi votuar për shkarkimin e një aksionari të LVV-së, të PSD-së në fakt, edhe me këtë rast kemi dashur që të ju japim mundësi të barabartë edhe dy aksionarë, për të krijuar çiftë bordin, çiftë për të ndërruar drejtorin apo për t'ia vazhduar mandatin.

Visare Gorani - Gashi, propozoi që kjo temë të mos diskutohet përderisa asnjëri nga anëtarët e LVV-së nuk janë të pranishëm.

Nol Nushi, propozoi shkarkimin e Egzon Azemit, aksionar në Ndërmarrjen Publike Banesore. Në emër të koalicionit, i propozoi dy emra të ri për aksionarë: Genc Sherifi dhe Suzana Kika.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin për shkarkimin e Egzon Azemit nga anëtari i Komisionit të aksionarëve.

Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, 3 kundër, u shkarkua Egzon Azemi nga pozicioni i anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve në NPB.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin për dy anëtarë të rinj, Genc Sherifi dhe Suzana Kika.

Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, 4 abstenime, u miratua Vendimi për emërimin e anëtarëve të rinj në Komisionin komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Banesore.

Mbledhja përfundoi në orën 15:50.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi



Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta

Faqe 6 nga 7